



Nr. 67.Prot
07.10.02.2026

Tiranë, më 10.02.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur sot më datë, ___ / ___ / 2026 ndërmjet palëve bashkëpunuese:

1. KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT(KUB) me NIPT: L02401014C, me Seli: Rruga "Gjergj Legisi", Nr.23, Laprakë, Tiranë, Cel. +355 69 88 99 999/ E-mail: info@kub.edu.al, përfaqësuar nga **Rektori Prof. Dr. Ylber BEZO**, madhor me zotësi të plotë për të vepruar,

DHE

2. Kompania/Studio Profesionale _____, NIPT: _____, me Seli: Rruga " _____ ", Tirane, E-mail: _____ përfaqësuar nga Administratori _____ madhor me zotësi për të vepruar.==

Palët me sipër pas një bisedimi paraprak kanë shprehur dëshirën me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara më poshtë:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Bashkëpunimi do të përfshijë angazhimin e secilës palë në fushat si më poshtë:

- a. Shkëmbim i kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucioneve në aktivitete didaktike, praktika studentore, seminare, workshope, konferenca kombetare e ndërkombëtare shkencore por edhe trajnime të ndryshme;
- b. Krijimi i mundësive dhe lehtësirave studentëve të KUB për kryerjen pranë palës tjetër të Praktikës Mësimore, Intershipe, Stazhe profesionale etj, si dhe mundësinë e zgjedhjes së studentëve më të mirë për punësim.
- c. Realizimin e studimeve të ndryshme dhe plotësimit të Anketimeve, për organizimin e panaiereve për Punësim të studentëve, për marketimin në Panairë, reklamimit dhe Promocionit të Produkteve, Mallrave apo Sherbimeve që ofron pala tjetër.
- d. Marrja dhe vlerësimi i mendimeve dhe propozimeve për përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të studimit, për angazhim dhe pjesëmarrje të palëve në konferenca dhe angazhime të tjera të kërkimit shkencor, kryerjen e aplikimeve pilot të kërkimit apo të teknologjive të reja pranë tyre.
- e. Trainimin e kualifikimin e vijueshem të punonjesve të tyre pranë KUB
- f. Organizim i përbashkët i kurseve speciale, trajnimeve, leksioneve të hapura apo seminareve në lidhje me tematika që kanë interes studimor ose praktik;
- g. Angazhim të përbashkët në projekte me qëllim zhvillimin e kapaciteteve në fushën e edukimit, trajnimit, bashkëpunim për organizim dhe pjesëmarrje në projekte zhvillimi për fushën e; arsimit, në evente të përbashkëta, ftesa në konferenca, ceremoni të lidhura me Kontabilitetin, Raportimin Financiar apo Auditimin etj;
- h. Krijimi i mundësive dhe lehtësirave logjistike dhe sallave dhe mjediseve të KUB, lidhur me nevojat për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të palës tjetër.
- i. Të tjera.



Neni 2 **Qëllimi i Marrëveshjes**

Marrëdhënie dypalëshe bashkëpunim dhe njohje të ndërsjelltë, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe kapaciteteve profesionale dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me kërkesat profesionale të tregut të punës në praktike dhe anasjelltas, ndikimi nga kërkesat e nevojës praktike, në përmirësimin e programeve dhe kurrikulave të edukimit dhe të përgatitjes të profesionistëve që nxjerr dhe diplomon KUB.

Neni 3 **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

Kompania/Studio Profesionale “ _____ ” merr përsipër:

- 3.1. Të presë, të sistemojë, të asistojë profesionalisht dhe të monitorojë studentët në zhvillimin e praktikës mësimore dhe realizimin e detyrave të dhena, për një periudhë prej _____ muaj (_____ Jave)(Internship). **Ajo** njofton paraprakisht Kolegjin Universitar të Biznesit (Universitetin) mbi mundësitë e trajnimit dhe intershipit sipas kapaciteteve të veta. Për këtë qëllim caktohet një punonjës për ndjekjen e praktikës së studentëve.
- 3.2. Kompania/Studio Profesionale iu krijon kushtet e nevojshme të punës studenteve në ambientet e saj, duke iu ofruar dhe asistencën sipas departamenteve përkatëse të saj dhe duke njohur me procedurat e punës.
- 3.3. Studentet praktikante nevojitet të njihen me sa më tepër tipe kompanish biznesi dhe Fusha të ndryshme të aktivitetit të tyre dhe pastaj të njihen me sistemin, organizimin kontabel, trajtimin e vecorive të tyre dhe deri në hapat dhe procedurat e mbylljes së llogarive kontabel dhe përpilimin e Pasqyrave Financiare, dhe Informacionet specifike që duhen trajtuar në Shenimet Spjeguese të Pasq. Fin. të tyre.
- 3.4. Në përfundim të praktikës, punonjësi i caktuar bën një vlerësim me shkrim për punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale të studentit.
- 3.5. Kompania/Studio Profesionale informon Kolegjin Universitar të Biznesit (KUB) për datat për të cilat mundësohet internship për profilet e poshte përmendura duke garantuar të drejtën e ushtrimit të shërbimeve në kompani, part-time për dhe nga studentet. Kompania/Studio ofron shërbimet e internshipit dhe studentët do të kryejnë praktikën pa asnjë pagesë në këmbim të internship, në fusha të tilla si:
 - Shërbime Kontabiliteti dhe Auditimi me aplikim të SKK
 - Shërbime Kontabiliteti dhe Auditimi me aplikim të SNK/SNRF
 - Shërbime Kontabiliteti dhe Auditimi në Institucione Buxhetore/Publike
 - Shërbime Kontabiliteti dhe Auditime të Brendshme Sektori Privat ose Publik.
 - Shërbime Kontabiliteti dhe Konsulencë Tatimore e Doganore
 - Të tjera Shërbime Profesionale.
- 3.6. Në përfundim të praktikës profesionale kompania/studio profesionale ka mundësinë që duke identifikuar studentet me të mirë dhe ekselente, të mund t'i ofrojë mundësinë e

punesimit njerit apo disave prej tyre, duke plotesuar nevojat e veta, sipas profilit apo fushave profesionale ku jane nevojat e tyre.

Kolegji Universitar i Biznesit (KUB) merr përsipër:

- 3.6 Studentët e KUB do marrin pjese ne Internship sipas numrit te kerkuar dhe datave te pranuar dhe te vendosura nga Kompania/Studio Profesionale “ _____ ” profilet/fushat e kerkuara.
- 3.7. Të mbajë lidhje dhe të komunikojë me punonjës të ngarkuar nga Kompania/Studio “ _____ ” lidhur me ecurinë e praktikës profesionale, me qëllim realizimin e synimeve të saj.
- 3.8. Të ftojë përfaqësues të Kompanisë për trajnime, leksione të hapura, bashkëbisedime profesionale, evente, aktivitete dhe organizim panairesh punësimi. Kolegji Universitar I Biznesit (KUB) ofron 30% ulje të tarifës së vlerës për çdo shërbim të ofruar për punonjësit e Kompanisë/Studios.
- 3.9 Kolegji (KUB) e njofton Kompaninë/Studio “ _____ ” paraprakisht për trajnimet apo praktikën profesionale të studentëve, duke e njohur me datat dhe rregullat e Internshipit.

Neni 4

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe zgjidhja e marrëveshjes

- 4.1 Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe **është pa afat**.
- 4.2. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila palë në çdo kohë, me një njoftim me shkrim të paktën një muaj përpara, kundrejt palës tjetër.

Neni 5

Komunikimi

Palët angazhohen që të komunikojnë për çdo aktivitet që organizojnë në interes të ndërsjellë duke specifikuar detajet e nevojshme që sigurojnë një mirëkoordinim mes Palëve.

Në zbatim dhe në referencë të kësaj marrëveshjeje, palët, për aktivitete të posaçme dhe specifike, të dakordësuara midis tyre, hartojnë marrëveshje apo kontrata të veçanta dhe për periudha me afat më të shkurtër, të cilat nënshkruhen nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore të KUB dhe Përfaqësuesit e Palës tjetër.

Palët mund t'i drejtohen njëra tjetrës me shkrim në adresat zyrtare dhe mund të komunikojnë gjithashtu në të gjitha format e tjera të njohura të komunikimit.

Persona Kontakti të Palëve:

- | | |
|---|----------------------------|
| A. Për Kolegjin Universitar të Biznesit | B. Për Studio _____ |
| 1. Eni Danaj, Tel: 0698899999 1. _____ Tel: _____ | |
| email: kordinatorrekub@kub.edu.al | email: _____ |

Neni 6

Ndryshimi, amendimi dhe revokimi i marrëveshjes

Cdo pikë e kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve. Ndryshimet do të jenë të vlefshme vetëm pasi të jenë bërë në formë shkresore dhe të firmosen nga palët.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palet bien dakord, që çdo mosmarrëveshje midis tyre t'i zgjidhin me mirëkuptim. Kjo marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe, ose edhe në gjuhën anglese. Në dy kopje, nga një për secilën palë dhe është lexuar, kuptuar, dhe nënshkruar me vullnetin e lirë të tyre.

KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT

Pala Studio _____

REKTORI

Administrator

Prof. Dr. Ylber BEZO


